



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

<b>DATË/A:</b>	20.01.2025
<b>REFERENC-Ë:</b>	24/5411/MMPHI
<b>PËR/ZA/TO:</b>	"Panda-T" Sh.p.k., Prishtinë Prodhimi dhe montimi i mjeteve piroteknike , fishekzjarrëve, Vranidoll, Prishtinë
	Komisioni për Leje Mjedisore.
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	Arkivës së MMPHI-së
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Izedin Bytyqi, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI.
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Vendim për ndëprerje procedurës së Lejes Mjedisore.

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për vazhdimin e Lejes Mjedisore të operatorit, "Panda-T" Sh.p.k., Prishtinë, për veprimtarinë: Prodhimi dhe montimi i mjeteve piroteknike , fishekzjarrëve, Vranidoll, Prishtinë

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Me respekt!



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

Nr.: 24/5411/MMPHI

Datë: 20.01.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr.13/2024 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 3 të nenit 10, të Udhëzimit Administrativ MPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerrë këtë:

## V E N D I M

1. Operatorit, "Panda-T" Sh.p.k., i ndërpritet procedura administrative për veprimtarinë: Prodhimi dhe montimi i mjeteve piroteknike , fishekzjarrëve, në ngastren nr.01156-1 zona kadastrale Vranidoll, Prishtinë.

## A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin, "Panda-T" Sh.p.k., me nr. pot.24/5411/MMPHI, për veprimtarinë: Prodhimi dhe montimi i mjeteve piroteknike , fishekzjarrëve, në ngastren nr.01156-1 zona kadastrale Vranidoll, Prishtinë. MMPHI Konstatonë që operatori nuk i plotëson kriteret e parapara me Udhëzim Administrativ 04/2022/MMPHI, për pajisje me Leje Mjedisore.



Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit-ARBK;
- Pëlqim Mjedisor me Nr. 22/6820/1-ZSP/85/23, te lëshuar me datë: 06.02.2023;

MMPHI, ka kontrolluar dokumentacionin dhe në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.04/2022, ka kërkuar nga operatori plotësim të dokumenteve si në vijim:

- Pëlqimin e AME-së;
- Leje ujore për shfrytëzim dhe
- Leje ujore për shkarkim.

Operatori nuk ka sjell dëshmi për plotësimin e dokumentacionit të cekur me lartë.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, **ndërpret procedurën administrative** në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.



Izedin Bytyqi

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Prishtinë;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së